

# E PERKOHESHMIA SHQIP

## LA REVUE ALBANAISE

**Qelhimi i se perkoheshmés « Albania » eshte ky : te shuhén lufterat, te mos dérdhét me ghak ne Shqiperi, po te kéte paqe dhé bashkim, é mé urdherim te Lartmadhesisé Tij Sulhtanit édhé mé ndihmen é Zotit Math te behén shkollha shqip dhé kombi shqiptar te véje perpara ne dituri dhé ne miresi dhé te kuptoné ku jane ntréshtét é tij te vertéta.**

**U lutémi téper memedhétarevé qi marin te perkoheshmén « Albania » ne Shqiperi, te nos miaftohén t' a kendojne per vétén é tyré, po te mlédhin prindrit édhé miqte dhé sa nërezi t' u mundét, naten rhéth é rhotulh vatres, dhé t' u kendojne ghithe artikelat duké dhene te kuptojne mirefilhit.**

### Č' BEJTIM

**Q**E te ghukojne mire memedhétaret č' pune ka bere kio é perkoheshmé « Albania », duhét te kujtojne shtétin ku ndodheshin punerat é kombit në mot me pare.

Ne č' mendjé qéne Shqiptaret, punonin a po nuk, ish shprése é madhé per te miresuar pake ghendjén é memedhét, č' nghanin č' nuke nghanin ne Shqiperi, č' biblha č'palheshin, funt si duhësh punuar : te ghitha keto ishin n' éresire para daljés « Albanies », dhé vétém goja gojes — do mé there liksh — méreshin vésh. Ish névoje é madhé per në ditetoré shqip; dhé, per ata qi kuptuan kete névoje, ish detyre te perpigén mé č' do menyre per te sjélhe ne drite kete ditetoré.

Te tjére sé né kishin mendimin dhé qelhimin te vene ne udhe në pune aqe te mbare per kombin shqiptar; por as në nuke kuxojti keto vjété te mare siper vétés në pune aqe te rende : pa trembur, pa péshuar kete dhé ate, duké deghuar vétém zen' é detyres, leshuam ghithe punerat qe, si tere bota, kishim per te zene, dhé é bejtim fora « Albanien ».

I pari ndalim ish — a do there? — érglendi. Édhé te kéte miaft te holha në nëri, a tré a kater véta qofshin, në ditetoré s' mbahét pervéč mé ndihmen é te ghithevé; se, lé qe shtypi kushton miaft shtreñt ne keto visé ketéj, po duhén dhé

te holha shume per dergimin é perditeshme te létravé, numeri i se cilavé vété duké shtuar. Mjérisht, Shqiptaret é pasur qi mundin te ndihin, ne vent qe te japin, shkaké kerkojne per te mos dhene.

Tjéter në é rende pune ish t' i bejme Shqiptaret é brendeshme t' u kéte enda te kendojne ghuhen é tyré. Edhé kio s' eshte në ghe é paket; sé ditetoré shqip Shqiptaret as qe dinin si muntté te behéj, ca me pake u pristé mendia t' a desheronin mé régulhe é t' a kendonin mé fitim.

Lé te veme ré tani vobesin' é ghuhes shqip, pa fjale te shuma dhé te miafta per te č'faqur mirefilhit mendimét. Ne č' do artikelh, ne č' do vije, ne č' do tok fjalesh, shkroñetori esht i pénguar, sé do te thote dhé s' thote dot, ka mendimé per te cilet nuke ghen fjale; shkurt, midis shkroñetorit dhé ghuhes shqip eshte si në lufte, ne te cilen shkroñetori s' dél udob mundetor. Ghuha shqip ka qene dhé qé ghuhe per pralha bukuroshé dhé te léhta, per kenga dasmoré dhé te populhit, po nuk ish ghuhe mé te cilen te muntté nëriu, ne në te perkoheshmé létrérishtë, te shkruanté mendimé te holha dhé te rihité punera te ngatruara dhé te koklavitura.

« Albania » leftoj memedhélarisht kundre ketyré ndalimévé. Shqiptaret é pasur mesuan ca me shume sé ne kohen é shkuar te ndihin per

